



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 8 Regj. Themeltar
Nr. 8 i Vendimit**

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

**Sokol BINAJ Kryesues
Ervin PUPE Anëtar
Klodian KURUSHI Anëtar**

në datën 16.09.2021 mori në shqyrtim, në dhomën e këshillimit, çështjen administrative me nr. 8 akti me:

KËRKUES: Kujtim Llagami

OBJEKTI: Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut; Neni 399, pika 1 e vijues i Kodit të Procedurës Civile.

KOLEGJI ADMINISTRATIV

pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Binaj dhe diskutoi, në dhomë këshillimi, çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se, kërkuesi Kujtim Llagami, nga data 28.02.2013 deri në datë 17.02.2014, ka qenë në marrëdhënie punësimi pranë palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në pozicionin e “Specialistit”, referuar shënimit të bëra nga punëdhënësi në librezën e punës të punëmarrësit.

2. Rezulton se pala e paditur, e ka marrë në periudhë prove punëmarrësin (paditësin) dy herë në mënyrë të njëpasnjëshme, me nga tre muaj dhe më pas në periudhe prove prej 6 muajsh.

3. Me shkresën nr. 4081 prot., datë 13.02.2014 nga ana e punëdhënësit është bërë vlerësimi i punës së punëmarrësit, ku sipas përmbajtjes se shkresës punëmarrësi nuk ka kryer detyrat e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ndaj nuk përmbush kriteret për të kaluar me sukses periudhën e provës.

4. Me shkresën me nr. 4081/1 prot., datë 17.02.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave është zgjidhur në mënyrë të njëanshme kontrata e punës, me motivacionin pasi punëmarrësi nuk ka përmbushur brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit detyrat specifike të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

5. Pala paditëse i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin për zgjidhjen e kontratës së punës.

6. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 2514, datë 20.05.2014, ka vendosur:

“Pranimin e pjesshëm të padisë. Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të dëmshpërblej në total punëmarrësin, që është pala paditëse, Z. Kujtim Llagami, me 6 (gjashtë) paga mujore të pagueshme (neto) që ka përfituar në momentin e përfundimit të marrëdhënies së punës, si dhe me pagën e pagueshme ditore (neto) për datat 01.03.2014 deri në datë 31.03.2014, si pasojë e shkeljeve ligjore të kryera prej saj në zgjidhjen e njëanshme të kontratës së punës. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërimit kundrejt palës së paditur si të pambështetur në ligj dhe në prova”.

7. Kundër vendimit nr. 2514, datë 20.05.2014 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka paraqitur ankim pala paditëse (kërkuesi), Kujtim Llagami, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesë padisë.

8. Kundër vendimit nr. 2514, datë 20.05.2014 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka paraqitur ankim pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesë padisë.

9. **Gjykata Administrative e Apelit**, me vendimin nr. 736, datë 07.04.2016, ka vendosur:

“Ndryshimin e vendimit nr. 2514, datë 20.05.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në këtë mënyrë: Pranimin e pjesshëm të padisë. Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, që t'i paguajë paditësit, Kujtim Llagami, dy paga mujore për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit të saj”.

10. Kundër vendimit nr. 736, datë 07.04.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit, është paraqitur rekurs nga palët, çështje e cila është regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 31003-01127-00-2016, datë 19.07.2016 regjistrimi me :

11. Kërkuesi, Kujtim Llagami, në datë 21.06.2021 i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë“për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjyqimit të çështjet së tij me nr. 31003-01127-00-2016, datë 19.07.2016 regjistrimi, i Kolegjit Administrative Gjykatës së Lartë”.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) konstaton se kërkesa është paraqitur nga një subjekt i cili legjitimohet. Pala kërkuese rezulton të jetë me cilësinë e palës paditëse në procesin gjyqësor, për të cilin është dhënë vendimi nr. 736, datë 07.04.2016 i Gjykatës Administrative të Apelit. Mbi rekursin e ushtruar nga palët ndërgjyqëse çështja është regjistruar me nr. 31003-01127-00-2016, datë 19.07.2016 në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

13. Kolegji vlerëson se kërkesa është në kompetencën e tij, sipas nenit 399/6, pika 1, shkronja “c”, të Kodit të Procedurës Civile, pasi përmes saj kërkohet konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes nga Kolegji Administrative i Gjykatës së Lartë.

14. Kërkesa i plotëson elementët e parashikuar në nenin 399/5, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile, si dhe është e shoqëruar me të gjitha aktet e tjera të nevojshme, të përcaktuar në nenin 399/5, pika 2, të Kodit të Procedurës Civile.

15. Kolegji vlerëson se parimi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm ka një rëndësi themelore për gjykimin civil/administrativ, pasi përbën dhe një nga komponentët e procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Ky parim bazohet në postulatin “*drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar*”. Shkalla e respektimit të këtij parimi përcakton në mënyrë të ndjeshme dhe efektivitetin e procesit gjyqësor. (*Shih vendimin H. kundër Francës, datë 24.10.1989 të GJEDNJ*)

16. Kolegjin çmon të theksojë praktikën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), e cila ka përcaktuar se periudha e afatit të arsyeshëm për përfundimin e një procesi gjyqësor civil shtrihet, që nga momenti i ngritjes së padisë deri tek momenti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor. (*shih vendimin Qufaj kundër Shqipërisë; Vendimin Scopelliti kundër Italisë, datë 23.11.1993 të GJEDNJ*). Gjykata ka një pozitë kryesore dhe të veçantë, pasi është i vetmi organ që është përgjegjës për dhënien e drejtësisë dhe si e tillë merr pjesë në mënyrë të detyrueshme në të gjitha marrëdhëniet që krijohen gjatë gjykimit të çështjes.

17. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ) në jurisprudencën së saj, ka identifikuar disa elemente përbërëse të këtij standardi. Sipas kësaj jurisprudence në përlllogaritjen e afatit të arsyeshëm merren në konsideratë faktorë të ndryshëm si kompleksiteti i çështjes; sjellja e palëve ndërgjyqëse; sjellja e autoriteteve gjyqësore dhe administrative. (*Shih vendimin Buchholz kundër Republikës Federale Gjermane datë 06.05.1981 dhe Bjeliç kundër Sllovenisë ap. nr. 50719\06, datë 18.10.2012. të GJEDNJ*)

18. Kolegji vlerëson se për sa i përket kompleksitetit të çështjes, ky kriter vlerësimi merr parasysh të gjithë faktorët dhe elementet që kanë të bëjnë me çështjen, natyrën e interesave të përfshira në të, rëndësinë e fakteve, rëndësinë e zgjidhjes ligjore, numri i personave të akuzuar dhe të dëshmitarëve, elementet ndërkombëtarë, lidhjen e çështjes me çështje të tjera dhe ndërhyrjen e personave të tjerë në procedurë. (*Shih vendimin Trggiani kundër Italisë datë 19.02.1991; Manieri kundër Italisë datë 27.02.1992, Stefancic kundër Sllovenisë, datë 25.10.2012 të GJEDNJ*).

19. Për sa i përket sjelljes së kërkuarit, ky kriter lidhet me mënyrën se si janë sjellë palët në proces ndaj procedimit, dilgjencën e treguar prej tyre për përfundimin e procesit, pengesat që ato kanë krijuar dhe faktorë të tjerë që janë të lidhur me veprimet ose mosveprimet e tyre që kanë ndikuar në ecurinë e procesit. Megjithatë, kjo duhet vlerësuar rast pas rasti vlerëson gjykata, pasi një person nuk është i detyruar të bashkëpunojë me autoritetet proceduese në mënyrë aktive për të përshpejtuar procedurat gjyqësore që çojnë në dënimin e tij. (*shih vendimin Eckkle kundër Republikës Federale Gjermane, datë 15.07.1982 të GJEDNJ*)

20. Nga ana tjetër, Kolegji sjell në vëmendje se, për sa i përket sjelljes së autoriteteve për vlerësimin e kohëzgjatjes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, GJEDNJ ka vlerësuar se vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të merren parasysh. Këto vonesa mund të shkaktohen ose nga autoritetet gjyqësore ose nga autoritetet administrative. Shkaqe të kësaj natyre në jurisprudencën e GJEDNJ janë vënë në dukje si p.sh. bashkimi i gabuar i disa çështjeve që ka shkaktuar vonesa të panevojshme, shtyrjet e pabazuara në ligj të seancave gjyqësore, pezullimi i kundërligjshëm i procesit gjyqësor, vonesat nga ana e agjencive publike ligj zbatuese të shtetit në dorëzimin e provave të kërkuara nga gjykata, transferimi i çështjeve penale nga një gjykatë në tjetrën, mbajtja e seancave të apelimeve. (*Shih vendimin Eëing kundër Mbretërisë së Bashkuar*).

21. Në çështjen objekt gjykimi, Kolegji konstaton se në momentin e regjistrimit të kërkesës në Gjykatën e Lartë rezultoi se çështja e ka kaluar afatin e shqyrtimit në Gjykatën e

Lartë, siç përcaktohet në nenin 399/2, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Civile (2 vit), pasi nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën e Lartë dhe deri në paraqitjen e kësaj kërkesë ka kaluar një kohë prej rreth 5 vjet.

22. Duke marrë në vlerësim standardet e përcaktuara nga jurisprudenca e GJEDNJ në lidhje me afatin arsyeshëm, nuk rezultojnë se që çështja objekt gjykimi të jetë pezulluar, të jetë shtyrë gjykimi për shkak të kërkesave të palës kërkuese. Çështja nuk paraqitet shumë komplekse nga natyra e saj, pasi ka të bëjë me të drejtat reale që rrjedhin nga sendi i paluajitshëm, të drejta të cilat pretendohen se janë cenuar nga veprimet e paligjshme të palës së paditur, organ i administratës publike. Nga ana tjetër, nuk konstatohet ndonjë sjelle e palëve që të ketë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit, për sa kohë, që nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën e Lartë e deri në këto momente nuk është kryer asnjë veprim procedural.

23. Kolegji vlerëson se në lidhje me mosveprimin e gjykatës që nga momenti i depozitimit të ankimit e deri në datën që kërkuesi ka paraqitur kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të shqyrtimit, duhet mbajtur në konsideratë ngarkesa totale individuale e gjyqtarit relator si dhe ngarkesa e këtij të fundit. Në lidhje me çështjen objekt gjykimi u konstatua se gjyqtari relator ka ndryshuar si pasojë e zbatimit të reformës në drejtësi, procesi i verifikimit të gjyqtarëve/prokurorëve në Shqipëri.

24. Kolegji vlerëson të theksojë se vonesa e gjatë në shqyrtimin e mosmarrëveshjes konkrete objekt gjykimi, është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret. Përbën një fakt të njohur botërisht se reforma në drejtësi ka shkarkuar/pezulluar një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh në Republikën e Shqipërisë. Ky proces natyrshëm ka krijuar kosto për qytetarët në tejkthyerjen e afateve për gjykimin e çështjeve gjyqësore. Këto vështirësi janë proporcionale në raport me të mirën e përgjithshme që padyshim krijon procesi i reformës.

25. Komisioni i Venecias ka theksuar se reforma në drejtësi, procesi i verifikimit të gjyqtarëve/prokurorëve në Shqipëri, ishte e domosdoshme edhe nëse do të sillte pasoja të paparashikuara. Përveç aspekteve të padyshimta pozitive mbi cilësinë e gjyqësorit në planin afatgjatë, në një periudhë afatshkurtër procesi i verifikimit ndikon në numrin e gjyqtarëve aktiv në sistem duke shkaktuar problem të përkohshme praktike derisa të bëhet zëvendësimi i tyre (*Shih European Commission for Democracy through law (Venice Commission) Albania opinion on the appointment of judges to the Constitutional Court*).

26. Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje “Raportin mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2020”. Në gjetjet e këtij raporti rezultojnë se sistemi gjyqësor në vendin tonë parashikon se Gjykata e Lartë, në të cilën gjatë vitit 2020 kanë ushtruar detyrën 3 gjyqtarë, të cilëve i janë shtuar edhe 4 gjyqtar në vitin 2021. Nga të dhënat e raportit rezultojnë se në Gjykatën e Lartë, rezultojnë se Backlog-u në fund të vitit 2020, vitit referues, rezultojnë prej 36.288 çështje dhe janë regjistruar 3,246 çështje të reja gjatë vitit 2020. Nga shqyrtimi i kushteve dhe të dhënave në raport evidentohet fakti se Gjykata e Lartë është koshiente për problematikën, prioritarizon çështjet e vjetra duke ulur numrin e çështjeve jashtë afatit.

27. Kolegji vlerëson se rrethanat e mësipërme janë pasur në vëmendje edhe nga ligjvënësi në kohën e miratimit të ndryshimeve ligjore, konkretisht me ligjin nr. 38/2017 të Kodit të Procedurës Civile duke parashikuar Kreun X “Gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit”. Neni 399/2 pika 3 e Kodit të Procedurës Civile parashikon: “Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, sipas këtij kreu, ose kur shfaqen rrethanat të pamundësisë objektive për procedim.”. Kolegji çmon se legjislatori, me ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile ka parashikuar shprehimisht rrethanat e pamundësisë objektive për llogaritjen e afateve në kohëzgjatjen e gjykimit si një shkak objektiv që shkarkon nga

përgjegjësia për tejkalimin e afatit të fiksuar në nenin 399/2 pika 2 të Kodit të Procedurës Civile.

28. Për sa më sipër, rezulton se mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit. Gjyqtari ka realizuar dhe një praktikë sesi merr në shqyrtim çështjet për të cilat është në cilësinë e relatorit. Rezulton se shqyrtimi i tyre bëhet duke marrë në konsideratë çështjen më të hershme të regjistruar. Kolegji vlerëson se duke marrë në konsideratë rastet që GJEDNJ ka përcaktuar se çfarë përbën sjellje të gjykatës, e cila ndikon në cenimin e parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, vlerësohet se rastet kur gjykata është në pamundësi objektive dhe pa vullnetin e saj, për të gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, për shkak të ngarkesës së madhe, akumulimit ndër vite të dosjeve në gjykatë, shkurtimeve të numrit të gjyqtarëve në sistem nuk përbëjnë cenim të këtij standardi. Gjyqtari relator ka marrë të gjitha masat e nevojshme duke përcaktuar dhe kriteret transparente për marrjen sipas radhës së vjetërsisë të çështjeve që i janë caktuar në cilësinë e gjyqtarit relator.

29. Kolegji vlerëson se parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk duhet të keqkuptohet, pasi shpejtësia e kryerjes së veprimeve procedurale nuk e përjashton, përkundrazi, e nënkupton kryerjen me cilësi të këtyre veprimeve të gjykatës. Në asnjë rast cilësia e procesit të rregullt ligjor dhe e vendimmarrjes së gjykatës nuk duhet të sakrifikohet për sasinë e afatit të arsyeshëm apo edhe ekonominë gjyqësore në tërësi.

30. Mbështetur sa më sipër, për sa më sipër, Kolegji vlerëson se duhet të vendoset rrëzimi i kërkesës pasi nuk vërehet ndonjë zvarritje e qëllimshme e saj nga gjyqtari relator.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 399/8, pika, shkronja b) të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës, së kërkuarit Kujtim Llagami.

Tiranë, më 16.09.2021

ANËTAR

Klodian KURUSHI

ANËTAR

Ervin PUPE

KRYESUES

Sokol BINAJ